



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 6571 prot.

Data: 21, 5, 2024

VENDIM

Nr. 6571, Datë 21, 5, 2024

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; në urdhrin nr. 128, datë 6.7.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

1. **Emri i ofruesit të AFP-së:** Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Durrës
2. **Akti zyrtar i themelimit/licencimit:** Urdhër nr. 269, datë 20.9.2002, protokolluar me nr. 3442/1 prot, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për hapjen e klasave shitesë në shkollat profesionale", Shkresa nr. 7078/2 prot, datë 1.10.2017, me lëndë: *Miratim kërkesë*, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës lidhur me hapjen e një klase të parë dhe një klase të katërt të degës Hoteleri-Turizëm.
3. **Organizimi i institucionit:** Shkollë e mesme profesionale publike
4. **Lloji i ofruesit të AFP-së:** Shkollë e mesme profesionale
5. **Nipti:** L51327751J

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

konstatoj se:

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;

c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

1. Akreditimin me kusht për kualifikimet profesionale:
 - a) “Teknologji Ushqimore”, Niveli II në KSHK, A-II-21
 - b) “Teknologji e Përpunimit të Brumërave”, Niveli III në KSHK, A1-III-22
 - c) “Teknologji Ushqimore”, Niveli IV në KSHK, A-IV-18
 - d) “Detari”, Niveli II në KSHK, J-II-20
 - e) “Peshkim”, Niveli III në KSHK, J1-III-21
 - f) “Detari”, Niveli IV në KSHK, J-IV-17
 - g) “Tekstil – Konfeksione”, Niveli II në KSHK, D-II-17
 - h) “Rrobaqepësi”, Niveli III në KSHK, D1-III-19
 - i) “Tekstil – Konfeksione”, Niveli IV në KSHK, D-IV-19
 - j) “Ekonomi Biznes”, Niveli II në KSHK, L-II-21
 - k) “Llogari”, Niveli IV në KSHK, L4-IV-19
2. Afati përfundimtar i akreditimit me kusht është 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
Në përputhje me propozimin përkatës nr. 156/10, datë 08.11.2023 ardhur nga AKAFPK (bashkëlidhur këtij urdhri):
3. Ofruesi i AFP-së të plotësojë rekomandimet e paraqitura në propozimin përkatës nr. 156/109, datë 08.11.2023, ardhur nga AKAFPK-ja, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
4. Ofruesi i AFP-së t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

